



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 21440/1 Prot.

Tiranë, më 6...12...2019

Lënda: Kthim përgjigje

Z. FILIP ÇAKULI / TOP CHANNEL

**Adresa: Rruga "17 Nëntori" Godina Nr. 20, Mëzez Kodër, Kashar
TIRANË**

Në përgjigje të kërkesës tuaj Nr. 981 Prot. datë 21.11.2019, protokolluar në DPT me Nr. 21440 Prot. datë 22.11.2019, ku kërkon informacion mbi subjektin "Genklaudis" sha në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit", regjistruar me nr. 148 në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, pas shqyrtimit të kërkesës, e cila ishte në përputhje me nenin 11 të ligjit të sipërcituar, ju informojmë si më poshtë vijon:

Aktualisht në subjektin "GENKLAUDIS" sh.a me NIPT K76911001E po zhvillohet një procedurë kontrolli nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në përmbushje të detyrave funksionale të kësaj strukture. Deri tani është hartuar një raport paraprak, i cili do të jetë pjesë e raportit përfundimtar të kontrollit, që aktualisht është drejt përfundimit. Raporti Përfundimtar i Kontrollit do t'i japë përgjigje edhe pyetjeve konkrete teknike mbi gjetjet në këtë subjekt.

Sqarojmë së në ligjin nr. 9920/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 24 "Dhënia e informacionit tatimor nga Administrata Tatimore" përcaktohet se, informacioni tatimor për tatimpaguesin, i administruar nga Administrata Tatimore, u ofrohet pa pagesë autoriteteve të përcaktuara në këtë nen, pas depozitimit të kërkesës me shkrim dhe kur verifikohen rrethanat e mëposhtme:

a) gjyqtarit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje civile, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;

b) gjyqtarit apo prokurorit, nëse është në gjykim ose në hetim të një çështjeje penale, të lidhur me një tatimpagues, për pjesën që u takon marrëdhënieve të tij me administratën tatimore;

c) Kontrollit të Lartë të Shtetit, vetëm për rastet, kur kërkesa e bërë është në funksion të kontrollit të kryer nga ky institucion ndaj administratës tatimore, në funksion të hartimit të rekomandimeve të veta;

ç) autoritetit të ngjashëm të huaj, me të cilin Kuvendi ka ratifikuar marrëveshje ndërkombëtare dhe informacioni kërkohet në kuadër të ekzekutimit të marrëveshjes;

d) autoritetit homolog të huaj ose autoriteteve vendase, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dy ose shumëpalëshe, me objekt shkëmbimin e informacionit;

dh) institucioneve të pavarura, të krijuara me ligj;

e) çdo autoriteti tjetër, sipas parashikimit të bërë me ligj të veçantë.

Theksojme se, Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" neni 7, ka listuar kategoritë e informacionit që autoritetet publike kanë detyrimin të vënë në dispozicion të publikut.

Përsa më sipër, informacioni kërkuar nga Ju, në lidhje me vënien në dispozicion të Raport Kontrollit përfundimtar për subjektin "GENKLAUDIS" sh.a me NIPT K76911001E, nuk është informacion, të cilin Administrata Tatimore mund t'ua vëje në dispozicion.

Në përfundim të procesit, Raport Kontrolli përfundimtar do t'i vihet në dispozicion subjektit të lartëpërmendur, të cilit i lind e drejta e ankimimit.

Përsa i përket procedurave të ndjekura nga strukturat e Hetimit Tatimor, sqarojmë se kjo strukturë në bashkëpunim me strukturat e krimit ekonomik në Policinë e Shtetit, e ka referuar informacionin mbi subjektin "GENKLAUDIS" sh.a me NIPT K76911001E, pranë Prokurorisë Tiranë. Pas referimit, çështja administrohet nga strukturat e Prokurisë.

ZV. DREJTOR I PËRGJITHSHËM

